



BASHKIA LEZHE

Nr. 6883 prot

Dt: 15.5.26

URDHËR

Nr. 324 Dt. 15.5.2026

**NGRITJEN E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT
ONLINE TË BANESAVE SOCIALE**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, akteve nënligjore në fuqi për administrimin e programeve të strehimit social, si dhe nevojës për administrimin dhe funksionimin efektiv të sistemit online të aplikimeve për banesa sociale, u vendos: krijimi i strukturës përgjegjëse për menaxhimin e programeve sociale të strehimit:

URDHËROJ

1. Të ngrihet struktura përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe funksionimin e sistemit online të banesave sociale në Bashkinë Lezhë.
2. Struktura përgjegjëse përbëhet nga:
 - Përgjegjësi i Sektorit të Kujdesit Social – Koordinator i struktures
 - Specialisti i Strehimit Social – Administrator i sistemit
 - Specialisti i IT-së – Përgjegjës për mirëmbajtjen teknike të sistemit
 - Specialisti i Shërbimeve Sociale – Verifikimi i dokumentacionit social
 - Specialisti i Financës – Verifikimi i të dhënave ekonomike dhe financiare
 - Përfaqësues nga Njësitë Administrative – Ndërlidhës për aplikimet në terren
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndren

